Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 899/24
Data. 16.08.24

Prishtinë, 07 gusht 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2317 _2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085); Nenin 64 par. 2 të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Nr. 08/L-258); Nenin 17, Neni 18, Neni 19 par. 1 dhe Neni 20 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë; Nenin 14, Nenin 15 dhe 17 par. 5 dhe 6 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse; Metodologjinë e ZRRE-së, Nr. 01/2020 për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE; Dispozitivin nën pikën III dhe IV të Vendimit V_1740_2023 të datës 15 maj 2023; Vendimin V_927_2018 të datës 29 mars 2018; Vendimin V_1752_2023 të datës 18.08.2023 të nxjerr nga ZRRE; Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës, në lokacionin "Wind Park –Zatriç 1, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, Komuna e Rahovecit të datës 05.08.2024 nr. prot. 447/24 të shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., me adresë: Rr. "Agim Ramadani", nr. 125, kat 2/4 Prishtinë, Republika e Kosovës; dhe Vendimet, lejet dhe pëlqimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II. të këtij Vendimi,

në seancën e mbajtur më 07 gusht 2024 nxori këtë:

V E N D I M
PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

I. **I lëshohet AUTORIZIMI** shoqërisë "**EV Wind Park" SH.P.K.,** me Numër Unik Identifikues(NUI) 810734568 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1 me kapacitet të instaluar prej **35 MW**, ZK Zatriç Komuna e Rahovecit, sipas **VENDIMIT PËR LEJE NDËRTIMORE - Numri i vrojtimit të lejes: K.III-03/2024** nr. prot. 4802-2/24 të datës 02.08.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe **Vendimin për Pëlqimin Mjedisor** me referencë Prot. 2253-2/21 të datës 20.12.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës(në tekstin e mëtejmë: MMPHI).

II. **OBLIGOHET** - shoqëria "**EV Wind Park" SH.P.K.,** që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi, që të dorëzoj garancionin financiar në vlerë prej 7 % të vlerës së projektit, të

lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve, me vlefshmëri që mbulon periudhën njëzetekatër (24) muaj sipas Planin Dinamik të Realizimit të dorëzuar nga Aplikuesi.

III. Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 2,895,900.00€. (dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e nëntëqind Euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit, dhe në rast se nuk dorëzohet garancioni financiar në ZRRE brenda afatit ligjor sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij Vendimi, **ky Vendim për Autorizim do të ndërpritet dhe njëkohësisht do të shfuqizohet**.

IV. Autorizimi sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi i lëshohet shoqërisë "**EV Wind Park**" SH.P.K., sipas Planit Dinamik të Realizimit, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Energjetik me Erë.

V. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.

VI. Leja Mjedisore e lëshuar për projektin Energjetik për Kapacitetet e reja Gjeneruese, do të jetë kusht për fillimin e operimit komercial.

VII. Shoqëria "EV Wind Park" SH.P.K., do të lidh Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike (MBE) me Operatorin e Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) SH.A., për periudhën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Gjeneratori BRE me çmim referent të përcaktuar nga ZRRE në baza vjetore.

VIII. Shoqëria "EV Wind Park" SH.P.K., për Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1 dhe KOSTT sh.a. do të nënshkruajnë Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike (MBE) brenda tredhjet (30) ditëve, pasi të dorëzohet garancioni financiar sipas dispozitivit nën pikën III. të këtij Vendimi.

IX. Shoqëria "EV Wind Park" SH.P.K., brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh para fillimit të operimit komercial të gjeneratorit sipas dispozitivit nën pikën V. dhe VI. të këtij Vendimi, duhet ta njoftoj me shkrim Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe ZRRE-në, për datën në të cilën hyn në fuqi komerciale dhe vetëm pas nënshkrimit të Shtojcës 5 të MBE, për të aktivizuar procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të njehsimit (matjes).

X. Shoqëria "**EV Wind Park**" SH.P.K., për projektin Energjetik para hyrjes në operim komercial, duhet të pajiset me licencë për prodhim të energjisë elektrike nga ZRRE.

Arsyetim

- ZRRE, më 05.08.2024 nga shoqëria **"EV Wind Park" SH.P.K.,** ka pranuar kërkesën për lëshimin e Autorizimit për fillimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1 me kapacitet të instaluar prej 35 MW ZK Zatriç, Komuna e Rahovecit, Republika e Kosovës.
- Shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se pas pranimit të Vendimit V_1752_2023 të datës 18.08.2023 të lëshuar nga Bordi i ZRRE, sipas pikës 5 të këtij Vendimi ka

parashtruar kërkesën me shkrim me dëshmitë përkatëse për lëshimin e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës prej 35 MW, ZK Zatriç, Komuna e Rahovecit, brenda afatit të përcaktuar me këtë Vendim.

- Shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., sipas Vendimit V_1752_2023 të datës 18.08.2023, është obliguar që të pajiset me Marrëveshjen për Kyçje në Rrjet të lëshuar nga KOSTT sh.a., dhe Lejen ndërtimore për projektin Wind Park Zatriç 1, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI).

- Shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., brenda afatit të caktuar me vendim, është pajisur me Marrëveshjen për Kyçje në Rrjet të lëshuar nga KOSTT sh.a., dhe Lejen Ndërtimore për projektin Wind Park Zatriç 1 nga MMPHI.

- Shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., ka kërkuar që të lëshohet autorizimi për fillimin e ndërtimit për një periudhë njëzetekatër (24) muaj sipas planit dinamik të realizmit, marr parasysh specifikat e projektit, në mënyrë që të arrijnë të ndërtojnë Parkun Energjetik me Erë.

- Me Vendimin V_1752_2023 të datës 18.08.2023 Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1 me kapacitet prej 35 MW, është pranuar në kornizën e rregulluar dhe është garantuar lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 15 vjeçare, në pajtim me kushtet ligjore të përcaktuara me rregullën në fuqi në kohën e aplikimit.

- Afati i vlefshmërisë prej dymbëdhjetë (12) muaj i përcaktuar me Vendimin për Autorizimin Preliminar V_927_2018, ka filluar të rrjedh nga data e lëshimit të Vendimit V_1752_2023 të datës 18.08.2023, ku aplikuesi brenda kësaj periudhe i ka plotësuar dëshmitë e mbetura dhe sipas Rregullës së Autorizimit ka kërkuar me shkrim të lëshohet Autorizimi për fillimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era.

- Projekti është në përputhshmëri me strategjinë e energjisë dhe dokumentacionet relevante për zhvillimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë dhe projekti është i përfshirë në Panin Zhvillimor 2023-2031 të Komunës së Rahovecit.

- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës për lëshimin e Autorizimit për lejimin e ndërtimit të Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1 me kapacitet prej 35 MW, ZK Zatriç, Komuna e Rahovecit, dëshmive të kërkuara sipas Vendimit V_1752_2023 të datës 18.08.2023, përfshirë Marrëveshjen për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit të Kosovës të lidhur mes KOSTT sh.a. dhe shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., nr. 2184 të datës 31.10.2023, VENDIMIT PËR LEJE NDËRTIMORE - Numri i vrojtimit të lejes: K.III-03/2024 nr. prot. 4802/24 të datës 02.08.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrja të këtij vendimi ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

XI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

XII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- KOSTT sh.a.
- Komunës së Rahovecit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.

SHTOJCA I

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 17 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., me adresë: Rr. "Agm Ramadani", nr. 125, kat 2/4 Prishtinë, Republika e Kosovës; më 07 gusht 2024, **i lëshon këtë:**

AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1 me kapacitet të instaluar prej **35 MW**, ZK Zatriç Komuna e Rahovecit, sipas **VENDIMIT PËR LEJE NDËRTIMORE - Numri i vrojtimit të lejes: K.III-03/2024** nr. prot. 4802-2/24 të datës 02.08.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe **Vendimin për Pëlqimin Mjedisor** me referencë Prot. 2253-2/21 të datës 20.12.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

2. Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria "EV Wind Park" SH.P.K., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar si më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara Rregullën e Autorizimit.

3. Ky Autorizim lëshohet sipas planit dinamik të realizimit duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:

   2.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
   2.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.

5. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

6. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundoj sipas Nenit 19 par. 1 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE.

7. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezulloj këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.

SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin për Ndërtim** të shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, Parku Energjetik EV Wind Park Zatriç 1. me kapacitet të instaluar prej **35 MW**, ZK Zatriç Komuna e Rahovecit:

- **Vendimin -** për Shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave Nr. 01-298 të datës 30.09.2022 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Rahovecit,
- **Vendimin për Pëlqimin Mjedisor -** me referencë Prot. 2253-2/21 të datës 20.12.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI),
- **Vendimin për Kushte Ndërtimore** për kategorinë e tretë ndërtimi i Projektit Parku Energjetik EV Wind Park –Zatriç 1 -35 MW, Komuna e Rahovecit nr. Prot. 1841-2/24 të datës 15.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI),
- **Vendimin për Leje Ndërtimore-** Numri i vrojtimit të lejes: K.III-03/2024 nr. Prot. 4802-2/24 të datës 02.08.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI),
- **Marrëveshjen për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit të Kosovës -** Nr. 2184 të datës 31.10.2023 e lidhur mes KOSTT sh.a. dhe shoqërisë "EV Wind Park" SH.P.K.,
- **Dëshmi mbi të drejtat pronësore (**Kontratat për shfrytëzimin e tokës),
- **Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,**
- **Plani i Biznesit, dhe**
- **Plani Dinamik i Realizimit për realizimin e projektet prej njëzetekatër (24) muaj.**